

Takimi i Bordit EITI, 31 janar 2017

Më 31 Janar 2017, Sekretariati Shqiptar EITI organizoi takimin e rradhës të Bordit EITI në Tirana International Hotel. Ky takim u konceptua në dy pjesë, ku në pjesën e parë ekspertët ligjor znj. Zyhrada Kongoli dhe z. Florian Xhafa, nga kompania e kontraktuar Eurosupport-Fineurop Support S.r.l bënë një prezantim mbi analizën e kuadrit legjislativ dhe rregullator kombëtar shqiptar në zbatimin e standarteve EITI. Qëllimi i realizimit të këtij studimi konsiston në identifikimin dhe vlerësimin e dispozitave të Standartit EITI që janë të zbatueshme në kuadrin ligjor dhe rregullator kombëtar si dhe dhënien e rekomandimeve në lidhje me ndryshimet e nevojshme në legjislacionin përkatës me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së tyre me Standartin EITI. Draft Raporti Final për Rishikimin e Kuadrit Legjislativ do të konsiderohet i miratuar dhe do të vijohet me publikimin e tij ditën e premte datë 10 Shkurt 2017.



Në pjesën e dytë, Administratori i Pavarur Deloitte Audit Albania përfaqësuar nga znj. Jonida Vesiu dhe z. Elvis Ziu prezantuan draft Raportin EITI 2015 dhe diskutuan rreth pagesave të rakorduara deri më tani si dhe rreth problematikave dhe pasaktësive në raportimin e pagesave nga shoqëritë dhe tatimet, mbi mungesën e një regjistri të azhurnuar dhe publik për koncesionet në të tre sektorët, mungesa e informacionit për punësimin në hidro-energji, etj. Draft Raporti EITI 2015 do të konsiderohet i miratuar dhe do të vijohet me publikimin e tij ditën e nesërme datë 1 Shkurt 2017

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në bashkëpunim me Sekretariatit Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Albania) organizuan ditën e Henë, më 27 Shkurt 2017 një tryezë të rrumbullakët mbi "Transparenca dhe llogaridhënia në industrinë nxjerrëse në Shqipëri".



Kjo tryezë diskutimesh me sekretariatit dhe shoqërisë civile, organizuar për herë të parë në vend, kishte si qëllim krijimin e themeleve për bashkëpunim mes organizatave të shoqërisë civile dhe EITI Albania, për të intensifikuar dialogun mes dy aktorëve të rëndësishëm me ndikim në rritjen e transparencës në industrinë nxjerrëse. Standarti EITI, nënkupton vendosjen e transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit. EITI në funksion të transparencës, monitoron të ardhurat e kompanive që operojnë në sektorin nxjerrës, si dhe pagesat që kompanitë bëjnë në institucionet shtetërore, të cilat konsiderohen të ardhura për shtetin. Ndërkohë që organizatat e shoqërisë civile, të cilat gjenden në mënyrë të vazhdueshme pranë qytetarëve dhe manifestojnë interesat e tyre mund të sjellin në tryezën e diskutimit çështje tejet me vlerë si problematika të hasura, raste që kërkojnë vemëndje të veçantë dhe

propozime për përmirësim të vazhdueshëm në funksion të rritjes së transparencës nga këto industri. Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes EITI Albania dhe organizatave të shoqërisë civile është thelbësor në përbushjen e misionit të vetë EITIt. IQ Consulting kontaktoi gjithashtu edhe me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Partners Albania (organizatë ombrellë që financoon dhjetëra organizata të tjera që veprojnë në vend) për të siguruar shpërndarjen e informacionit në një bazë sa më të gjerë organizatash. E megjithë përpjekjeve të vazhdueshme për të siguruar pjesëmarrje e dialog konstruktiv, vetëm gjashtë organizata të shoqërisë civile iu përgjigjën ftesës dhe u paraqitën në takim. Pjesëmarrja e ulët e shoqërisë civile në këtë takim është një tregues i rëndësishëm i faktit se shoqëria civile në Shqipëri është ende e paqartë për rolin e saj thelbësor në këtë sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë me ndikim të drejtëpërdrejtë në cilësinë e jetës. Roli i shoqërisë civile si katalizator e ndryshimit dhe mobilizimit social është tejet i rëndësishëm në mobilizimin e opinionit publik për të mbështetur procesin e EITI Albania, duke nxitur presionin e shëndetshëm dhe konstruktiv për të influencuar formulimin e politikave apo procesit legjislativ. Për EITI Albania është me vlerë gjykimi asnjëherë i shoqërisë civile dhe vecanërisht sinjalizimi i rasteve në shkelje të cilat kërkojnë vemëndje të veçantë prej Sekretariatit.

Me organizatat pjesëmarrëse, gjatë takimit, u diskutua mbi mënyrat se si mund të nxitet angazhimi aktiv i organizatave të shoqërisë civile në konceptimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit të rritjes së transparencës në industrinë nxjerrëse. Faktorët ligjorë apo rregullatorë të cilët paraqesin pengesa dhe vështirësojnë pjesëmarrjen e lirë dhe aktive të shoqërisë civile në zbatimin e misionit të EITI ishin pjesë e rëndësishme e diskutimeve. Në takim u fol edhe për ndërtimin strukturës së duhur mbështetëse ligjore, procedurale si dhe praktike që do të ndihmonte organizatat e shoqërisë civile në nxitjen e dialogut për zbatimin e principeve të EITI.

Vizitë në ambientet e Antea Cement

Rritja e bashkëpunimit mes kompanive operuese në vend dhe Sekretariatit EITI bëri të mundur organizimin e një tjetër aktiviteti të rëndësishëm në dobi të transparencës në industrinë nxjerrëse.

Më 21 Mars 2017, Sekretariati Shqiptar EITI në bashkëpunim me Antea Cement Sh.A. organizuan mbledhjen e radhës të MSG-së në ambientet e Antea Cement në Borizanë të Krujës.

Ky takim nisi me fjalën përshëndetëse të Drejtorit Teknik të kompanisë z. Goce Cvetkoski, i cili falenderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre. Ai ndau me pjesëmarrësit edhe disa nga arritjet e Anteas ndër vite si dhe i njohu ata me raportin e Integruar të Përgjegjësisë Sociale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, që Antea Cement publikon çdo vit, për palët e interesit në kuadër të politikave transparente. Ai gjithashtu tha: "Ne jemi zotuar dhe suajmë sigurimin e produkteve të cilësisë së lartë për klientët tanë, duke krijuar kushte të kënaqshme të punës dhe standarde të larta për të punësuarit tanë, duke ofruar mundësi reale për zhvillim, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbi të gjitha duke siguruar sigurinë maksimale në punë. Ne jemi të angazhuar për të respektuar dhe për të mbrojtur mjedisin, duke përdorur teknikat më të mira të disponueshme, si dhe për të zbatuar një mënyrë rigorozë ligjin, duke përdorur praktikant anti-korrupsion në të gjitha transaksionet e biznesit tonë"



Më pas takimi vijoi me prezantimin e rregullores dhe performancës së Antea Cement mbi shëndetin dhe sigurinë në punë nga Z. Fatmir Koco, Drejtor i Shëndetit dhe Sigurisë. Siguria dhe shëndeti në punë janë masat parandaluese të marra që kanë si synim përmirësimin e kushteve gjatë

proçesit të punës, ruajtjen e jetës dhe integritetin e shëndetit të punëmarrësve që përfshihen në proçesin e prodhimit.


Antea Cement është gjithashtu e përkushtuar për të mbrojtur mjedisin, çështje që u trajtua në prezantimin e Znj. Stela Pepa, Drejtoresh e Përgjegjësisë Sociale dhe Mjedisore. Në kuadër të politikave që Antea Cement zbaton për çështjet sociale dhe ato mjedisore, së fundmi është kryer edhe një studim nga ekspertët mbi vlerësimin e ndikimit socialë dhe mjedisorë që Antea Cement ka pasur gjatë 5 viteve të para të operimit të saj. Ky studim është kryer në mënyrë që Drejtuesit e Antea Cement të kenë një pamje më të qartë të perceptimit që zonat përreth dhe jo vetëm, kanë për operimin e Antea Cement si dhe në kuadër të politikave për përmirësim të vazhdueshëm. Në vijim të gjetjeve bordin Drejtues i Antea Cement ka hartuar edhe një program për vitet 2015 -2020 mbi projektet që do të ndërmarrë kompania në kuadër të 4 shtyllave të përgjegjësisë sociale të korporatës që janë, shëndeti dhe siguria në punë, mbrojtja e mjedisit, transparencja dhe komunikimi i vazhdueshëm me grupet e interesit si dhe promovimin e përgjegjësisë sociale të korporatës. Sontazhi u mbajt në zonat e Thumanës, Borizanës, Mamurrasit, Shpërdhet, Picrraga dhe Brret. Gjithashtu, Antea Cement është fituese e disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është akredituar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë si kompania me praktikim më të mira në rehabilitimin e gurorëve.

Pjesëmarrësit u shoqëruan për në Dhomën e Kontrollit Qëndror dhe Laboratorin nga Z. Behar Disha, Drejtori i Prodimit, për të parë së afërmi proçesin e prodhimit. Më tej, vizita vazhdoi në karrierat e çimentos për të parë konkretisht shfrytëzimin e minierës dhe rehabilitimin e mjedisit. Aty u vu re edhe progresi i rehabilitimit ndër vite. Praktikën e shfrytëzimit ishin ato të shfrytëzimi me shkallë dhe rehabilitimet kryeshin paralelisht me operacionet e shfrytëzimit në mënyrë progresive. Antea Cement ka rehabilituar një sipërfaqe prej më shumë se 54000 m2 me një total pemësh të mbjella që i kalon 6600 pemë.

Ky aktivitet ishte një përvojë e mirë organizimi dhe Sekretariati EITI falenderon Antea Cement për përkushtimin në mirëadministrimin e minierës në zonën e Krujës dhe në veçanti falenderon z. Dritan Dervishaj, Drejtor Teknik i Karrierave pranë Antea Cement dhe si një ndër antarët më aktiv të Bordit Shqiptar EITI, i cili u angazhua në organizimin e këtij aktiviteti në dobi të transparencës.

Në datat 6-7 Mars 2017, grupi i Sekretariatit EITI Albania zhvilluan një sërë takimesh në Bashkitë e Fierit dhe Patosit me qëllim promovimin e Nismës EITI dhe prezantimin e Raportit EITI 2015.

Në Bashkinë Fier u zhvillua një takim me Administratorin e Përgjithshëm z. Florian Muçaj dhe Drejtoreshën e Degës të Financës zj. Leida Lira dhe punonjës të Bashkisë ku u fol për Nismën EITI dhe Raportin EITI 2015. Gjithashtu u diskutua për përfitimet financiare që Bashkia Fier kishte marrë nga renta minerare dhe që këto financime detyrimisht duhet të përdoren për investime publike, të cilat duhet të jenë të prekëshme nga banorët. Ndër problemet që u diskutuan ishte ai i ndotjes së mjedisit që shkaktohet nga kompanitë e shfrytëzimit të naftës kryesisht Bankers Petroleum.



Një takim i ngjashëm u zhvillua në shkollën e mesme Jakov Xoxa, ku u fol për Nismën EITI dhe përfitimet që ka komuniteti nga EITI. Gjatë takimit u diskutua mbi rolin që duhet të luajnë të rinjtë në komunitet në lidhje me këtë nismë.

Në datën 7 Mars takimet vazhduan në Bashkinë Patos si njësi administrative ku shtrihet zona më e madhe naftë mbajtëse ajo e Patos-Marinzës. Në këtë zonë ushtron aktivitetin prodhues kompania Bankers Petroleum. Në takim me Përgjegjësen e Zyrës të Financave, të Tatim Taksave si dhe punonjës të Bashkisë Patos u trajtuan problematikat që ka sjellë aktiviteti i kompanive të naftës, përfitimet financiare dhe pasojat kryesisht mjedisore që vijnë nga aktiviteti i këtyre kompanive. Gjithashtu u trajtua problemi i pasojave nga aktiviteti sizmik i shkaktuar nga Bankers Petroleum në zonën e Zharrzës. Në takim u prezantua dhe Raporti EITI 2015. Takime të ngjashme u zhvilluan edhe me grupe të ndryshme banorësh ku u trajtuan këto probleme.

Në 8-9 Mars 2017 stafi i Sekretariatit EITI Albania zhvilluan një sërë takimesh në qytetin e Bulqizës, me qëllim promovimin e Nismës EITI dhe prezantimin e Raportit EITI 2015.

Në Bashkinë Bulqizë u zhvillua një takim me n/kryetarin e bashkisë z. Adhurim Lika ku u fol për përfitimet financiare që Bashkia Bulqizë kishte marrë nga renta minerare. Sipas z.Lika, Bashkia Bulqizë për herë të parë deri në tetor 2016 kishte marrë një vlerë të konsiderueshme rreth 20 milion lekë të reja nga renta minerare. U diskutua që financimet e marra nga renta minerare, detyrimisht duhet të përdoren për investime publike, të cilat duhet të jenë të prekëshme nga komuniteti.



Zëvendës Kryetari i Bashkisë Bulqizë, e quajti Nismën EITI një organizëm ndërlidhës në përfundimin e bashkëpunimit mes pushtetit vendor, kompanive operuese dhe komunitetit.



Takim me të njëjtin tematikë u zhvillua edhe me stafin e Bashkisë Bulqizë ku morrën pjesë specialist nga Drejtoria e Taksave, Prokurimit, Specialist Inxhinier dhe nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Takimi me nxënësit e vitit të parë të shkollës së mesme profesionale të minierës na bëri të kuptojmë se minatori është një zanat i vështirë por që me kualifikimin e duhur mund të jetë shumë i përfitueshëm dhe me një prespektivë të gjatë për ata që angazhohen në këtë zanat.

Takimi me përfaqësues të kompanisë Albchrome, si kompania më e madhe e kormit në Shqipëri tregoi edhe njëherë rëndësinë e transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit.

Takim në Pogradec

Sekretariati Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Albania) organizuan më datë 15-16 Mars 2017 takime të drejtpërdrejta me qytetarë të rrethit të Pogradecit, përfaqësues të pushtetit vendor si dhe me nxënësit e shkollës së mesme "Muharrem Çollaku". Këto takime kishin si qëllim prezantimin e Raportit EITI 2015 si dhe rritjen e bashkëpunimit me subjektet e licensuara, pushtetin vendor dhe komunitetin në zonë. Në mungesë të Kryetarit të Bashkisë Pogradec Z. Eduart Kapri për disa angazhime të tjera, takimet u zhvilluan me Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike z. Polikron Balliu, Drejtorin e Financave z. Çelnic Basholli dhe z. Olger Molla, Përgjegjës IT. Në rrethin e Pogradecit numërohen gjithsej rreth dhjetë miniera hekuri dhe qymyri ku pjesa më e madhe e tyre janë jashtë përdorimit. Nga bashkëbisedimi me përfaqësues të Bashkisë Pogradec mësuam se kompania North Star Mining ka bërë kërkesë për rinovim licënsë dhe ka dorëzuar pranë Bashkisë Pogradec "Projektin e Nikelit në Gur të Kuq mbi Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis" pasi siç dihet prania e liqenit afër fshatit Memëlish dhe pak më tutje Guri i Kuq e bën këtë zonë një bukurie të turizmit Pogradecar. Takimet vazhduan me nxënësit e shkollës së mesme "Muharrem Çollaku", ku u pritëm nga Drejtoresha e kësaj shkolle znj. Eva Pjetri dhe z. Andrea Cana. Në këto takime u diskutua për Nismën EITI dhe përfitimet që ka komuniteti, si dhe rolin që duhet të luajnë të rinjtë në komunitet në lidhje me këtë nismë. Në një pyetje që z.Lluka Gjergo, Koordinator EITI i drejtoi nxënësve të shkollës "Muharrem Çollaku" nëse Guri Kuq duhet të jetë minier apo atrakcion turistik, nxënësit u përgjigjën një zëri, se Guri Kuq duhet të jetë vetëm një atrakcion turistik.



Takime të ngjashme u zhvilluan edhe me grupe të ndryshme qytetarësh ku ju shpërnda Raporti EITI 2015, fletpalosja, udhërrëfyese EITI si dhe stlilapsa me logon EITI.